



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:208032

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06875302

**C.nr.146/2015**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. (KEK) me seli në Prishtinë, sheshi “Nëna Terezë” nr.36, kundër të paditurit J.A.H.nga fshati C./Malishevë, me objekt kontesti “Kompensim i dëmit material”, vlera e kontestit 456.44 euro, në seancën publike të mbajtur me datë 20.02.2025 mori, dhe me po të njëjtën datë përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSTATOHET** se paditësja Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. (KEK) me seli në Prishtinë, **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.146/2015 të datës 08.06.2015, kundër të paditurit J.A.H.nga fshati C./Malishevë, për kompensim dëmi material.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. (KEK) me seli në Prishtinë, sheshi “Nëna Terezë” nr.36, me datë 08.06.2015 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit J.A.H.nga fshati C./Malishevë, me objekt kontesti: “Kompensim i dëmit material”, vlera e kontestit 456.44 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 08.09.2016 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurit, i cili në përgjigjen e datës 02.11.2016 e ka kontestuar në tërësi borxhin ndaj të paditurës.

Me datë 20.02.2025 me fillim prej orës 09:30, gjykata e ka caktuar seancën përgatitore, ku për paditësen ka prezantuar F.F.zyrtar ligjor pranë paditëses, kurse për të paditurin ka prezantuar personalisht i padituri J.H..

Gjatë kësaj seance, i autorizuari i paditëses (KEK) ka deklaruar se i padituri J.H. e ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj paditëses KEK, andaj e bëjnë tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadisë në këtë çështje kontestimore.

Lidhur me tërheqjen e padisë nga ana e paditëses, i padituri J.H. e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë dhe nuk e kanë kundërshtuar një gjë të tillë.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 par.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.2 të LPK-së, ku parashihet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë, ndërsa i padituri nuk e ka kundërshtuar një gjë të tillë, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Andaj në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.146/2015, datë 20.02.2025**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*